




Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 569/1 i datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e vet të mbajtur më 26 Shkurt 2015, merr këtë:

V E N D I M

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës së Rahovecit, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë banorët e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor të komunës për vitin 2015.
- II. Lartësia e shumës për mbulimin e shpenzimeve të varrimit do të jetë **200 (Dyqind) euro**, pa marr parasysh moshën, përkatësin fetare, apo vendin e vdekjes.
- III. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e autorizon Kryetarin e Komunës z. Idriz Vehapi, për të lidh marrëveshje mbi ofrimin e shërbimeve të varrimit dhe kompensimin e tyre, me të gjithë bashkësitë fetare që punojnë dhe veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, me të cilën marrëveshje do të specifikohen të gjitha shërbimet, raportimet dhe mënyra e kompensimit.
- IV. Banorët e komunës së Rahovecit do të kompensohen pasi që të dëshmojnë vdekjen në bazë të vërtetimit të mjekut dhe certifikatës së vdekjes, pranë Drejtorisë komunale për shëndetësi dhe punë sociale.
- V. Ky vendim do të ketë efekt retroaktiv dhe do të zbatohet prej **01.01.2015** deri në **31.12.2015**.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Punë Sociale në Rahovec.
- VII. Me hyrje në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimit 01 Nr. 242 i datës 30 janar 2015.
- VIII. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e komunës.

01 Nr. 647
Rahovec, 26.02.2015

Kryesuesi,

Nahit Elshani




KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE
Rahovec Orahovac
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Direkcija za Opštu Upravu

03-Nr.Br. 647 Më.Dt. 26.02.2015